



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA FIER

Nr. 918 Prot.

Fier më 23/01/2026

PROJEKT VENDIM

NR. 14 dt. 23/01/2026

Për autorizimin e ekzekutiv të Bashkisë Fier për përfaqësim ligjor dhe mbrojtje juridike pranë Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë edhe nëpërmjet shërbimit juridik të kryer nga një Studio Avokatie , në procesin gjyqësor pranë Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë .

Këshillit të Bashkisë Fier, sot më dt.../01/2026, i paraqitet për shqyrtim materiali nga ekzekutivi i Bashkisë Fier , në lidhje me përfaqësimin ligjor dhe mbrojtjen juridike të interesave ligjorë të Bashkisë Fier pranë Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë , për çështjen gjyqësore me palë paditëse Bashkia Fier kundër Drejtorisë së Apelimit Tatimor, Sektori i Apelimit të Dënimeve në Ministrinë e Financave , Tiranë , gjykatë pranë së cilës është depozituar kërkesë padia nga Bashkia Fier Nr.6968/1 Prot , datë 11/07/2025 . Nisur nga natyra e veçantë juridike , lidhur me legjislacionin për procedurat tatimore , objekt i ligjit Nr.9920 , datë 19/5/2008 “ Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë “ , i ndryshuar është e nevojshme krahas përfaqësimit ligjor dhe mbrojtjes juridike nga përfaqësuesi i Drejtorisë Juridike të Bashkisë Fier , ky përfaqësim dhe mbrojtje juridike të realizohet dhe me anë të një shërbimi juridik më të specializuar të ofruar nëpërmjet zgjedhjes së një Studio Avokatie me përvoja në çështje gjyqësore të kësaj natyre juridike , bazuar në Ligjin Nr..55/2018 “Për Profesionin e Avokatit në Republikën e Shqipërisë”.

Në mbështetje të Ligjit nr. 139/2015 “Për Vetëqeverisjen vendore”, i ndryshuar , neni 9 , pika 1.6, gërma “c” , Ligjit Nr.49/2012 “ Për Gjykatat Administrative dhe Gjykimin e Mosmarrëveshjeve Administrative “ , i ndryshuar, kërkesëpadisë Nr.6968/1 Prot , datë 11/07/2025 drejtuar Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë , bazuar në nenin 54 , pika “k” , Kryetari i Bashkisë ,

Propozon :

1. Të autorizojë ekzekutivin e Bashkisë Fier për realizimin e përfaqësimit ligjor dhe mbrojtjes juridike pranë Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë edhe nëpërmjet shërbimit juridik me anë të një Studio Avokatie , për shkak të natyrës së veçantë juridike të kësaj çështjeje gjyqësore ;
2. Shërbimi juridik i përfaqësimit dhe mbrojtjes juridike që do të kryhet nga përfaqësuesi i Studios së Avokatisë së zgjedhur do të shpërblehet bazuar në tarifat referuese miratuar nga legjislacioni në fuqi për mënyrën e shpërblimit të avokatit ;
3. Ngarkohet për zbatimin e këtij vendimi Kryetari i Bashkisë Fier, dhe ekzekutivi i Bashkisë Fier .

Konc.Drejtoria Juridike
Esmeralda Kapllanaj
Drejtorja e Taksave dhe Tarifave Vendore
Alda Abazi
Drejtorja e Financë, Buxhetit dhe Kontabilitetit
Pranvera Çina

KRYETAR
Armando Subashi

